

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konkursi për logon e QKVT, 4 muaj pa përgjigje: Pjesëmarrësit kërkojnë transparencë
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391501.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:10:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	14 shtator 2026, 09:54:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 14 shtator 2026, 09:53:00 UTC → 14 shtator 2026, 09:55:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a59087c9402bd5f347011b21c62dab24ea23917218264b3211d14d9ba52a0b9c
TEKSTI	a0cfd320b6df7f9e6cb30fbb5af3adaf3e746791c70a87b6f2fbfced4d96f221
PAMJA	f02d561dfde324c7101442af3415126e500b63254c992265fea7c464550bae28

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a8041e8de4ba343479db6431d1e0ecea90c07d2347c728749435555d1f7091d9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a8041e8de4ba343479db6431d1e0ecea90c07d2347c728749435555d1f7091d9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Konkursi për logon e QKVT, 4 muaj pa përgjigje: Pjesëmarrësit kërkojnë transparencë

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 14.09.2026, 11:54



Share



Share



Një qytetar ka kontaktuar redaksinë për të denoncuar mungesën e një përgjigjeje lidhur me konkursin për realizimin e logos së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (QKVT).

Sipas denoncuesit, në konkurs kanë marrë pjesë disa grafikë designer, të cilët kanë investuar kohë dhe punë për përgatitjen e materialeve të kërkuara. Pjesëmarrësit kanë dorëzuar propozimet e tyre për logon, së bashku me brandbook-un dhe prezantimet përkatëse.

Por, sipas qytetarit, kanë kaluar rreth katër muaj dhe nuk është dhënë asnjë përgjigje për konkursin. Ai thotë se deri më tani nuk është bërë e ditur asnjë përzgjedhje dhe nuk është shpallur fituesi.

"Kam marrë pjesë në konkurs dhe jam impenjuar për këtë gjë. Kemi harxhuar kohë, kemi përgatitur logon dhe brandbook-un dhe i kemi dërguar prezantimet, por prej katër muajsh nuk kemi marrë asnjë përgjigje", shprehet denoncuesi.

Sipas tij, afati fillestar i konkursit ishte 12 prill, ndërsa më pas u shty deri më 30 prill. Megjithatë, edhe pas përfundimit të këtij afati, pjesëmarrësit nuk kanë marrë informacion mbi rezultatet.

Denoncuesi thotë gjithashtu se ka tentuar të kontaktojë organizatorët përmes faqes së tyre në Instagram, por nuk ka marrë përgjigje.

Pjesëmarrësit kërkojnë transparencë lidhur me procesin e konkursit dhe sqarim mbi arsyen përse, pas disa muajsh, nuk është bërë ende e ditur përzgjedhja apo fituesi.


Redaksia mbetet e hapur për një reagim nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale lidhur me këtë denoncim.



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?



Nëpërmjet këtij emaili po ju dërgoj propozimin tim për dizajnin e logos.

Bashkangjitur do të gjeni konceptin e logos, si dhe një prezantim të shkurtër që shpjegon idenë dhe elementët kryesorë të përdorur në dizajn.

E kam konceptuar për të reflektuar një identitet vizual të qartë, të dallueshëm dhe të qëndrueshëm.

Jam i hapur për çdo sugjerim nëse është e nevojshme.

Faleminderit!

Me respek

One attachment • Scanned by Gmail ⓘ  Add to Drive



← Reply

→ Forward



Posts

Follow



39



2



12



qkvt.albania ⌚ Shtyhet afati, je ende në kohë!

Për t'i dhënë më shumë napesire pjesëmarrjes dhe krijimtarisë, QKVT ka shtyrë afatin e aplikimit për konkursin "Logo e re për QKVT", duke u dhënë mundësi të gjithë të interesuarve të bëhen pjesë e këtij procesi krijues.

📌 Dërgo propozimin tënd dhe kontribuo në ndërtimin e identitetit vizual të trashëgimisë sonë kulturore.

📅 Afati i ri i aplikimit: 30.04.2026

✉️ Aplikimet dërgohen në: Info@folklor.gov.al

👉 Mos e humb këtë mundësi për të qenë pjesë e identitetit të ri vizual!

🔗 Për më shumë informacion mbi kriteret dhe mënyrën e aplikimit, klikoni në linkun më poshtë:

<https://folklor.gov.al/logo-e-re/>

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt